

**STATUT**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**"Buddha House" shpk**

**KREU I**  
**THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA**

**Neni 1:**  
**Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit**

- 1) Sot, më 02.06.2024, ne, themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin "Buddha House" shpk.
- 2) Themeluesit e shoqërisë janë:
  - a) Tunahan Ozyurt, atësia Murteka, shtetas turk, identifikuar me anë të pasaportës me numër U35831305, me numër personal identifikimi J440120060 i datëlindjes 12.10.1994, lindur në Caycuma dhe banues në Vlore; madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
  - b) Huseyin Kurutas, atësia Kemal, shtetas turk identifikuar me anë të pasaportës me numër U26891719, me numër personal identifikimi 13925762410 i datëlindjes 13.11.1985 lindur në Bodrum dhe banues në Bodrum; madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
  - c) Umut Aydogan, atësia Adnan, shtetas turk, identifikuar me anë të pasaportës me numër U3359884, me numër personal identifikimi 15773240560 i datëlindjes 21.06.1992, lindur në Bodrum dhe banues në Bodrum; madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
  - d) Baran Oncu, atësia Cetin, shtetas turk, identifikuar me anë të pasaportës me numër U13206687, me numër personal identifikimi 21182523026 i datëlindjes 20.06.1991, lindur në Fethiye dhe banues në Bodrum; madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

**Neni 2:**  
**Objekti**

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

- 1) Menaxhim, operim Bar, Kafe, Pub, Restoran, Hotel, duke përfshirë këtu të gjithë ambjentet argëtuese; Pergatitje, prodhim, shërbim, shpërndarje, katering, delivery të të gjitha llojeve të ushqimeve; Tregtim me shumicë dhe pakicë të të gjitha që çdo lloji të mallrave dhe produkteve ushqimore, industriale, etj; Dhënie konsulencë për sa më sipër; Import – eksport i çdo lënde të parë, malli, pajisje, makinerie, shërbimi dhe produkti në funksion të aktivitetit; Shërbime reklame dhe marketingu të mallrave, artikujve dhe produkteve të ndryshme.

**Neni 3:**  
**Kohëzgjatja**

- 1) Kohëzgjatja e shoqërisë është e pacaktuar.

**Neni 4:**  
**Selia**

- 1) Shoqëria e ka selinë në: Vlore.
- 2) Me vendim të organit administrativ, shoqëria mund të hapë degë ose zyra përfaqësimi brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë.

**KREU II**  
**KAPITALI**

**Neni 5**  
**Kapitali themeltar**

- 1) Kapitali themeltar fillestare i shoqërisë është 1000000 (Nje milione) Lekë dhe është i ndarë në 4 (kater) kuota. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:
  - a) Ortaku themelues Tunahan Ozyurt , zotëruar i 1 (Nje) kuote me vlerë të përgjithshme 300000(Treqind mijë ) Lekë, që përben 30% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
  - b) Ortaku themelues Huseyin Kurutas, zotëruar i 1 (Nje) kuote me vlerë të përgjithshme 300000(Treqind mijë) Lekë, që përben 30% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
  - c) Ortaku themelues Umut Aydogan, zotëruar i 1 (Nje) kuote me vlerë të përgjithshme 200000 (Dyqind mijë)Lekë, që përben 20% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
  - d) Ortaku themelues Baran Oncu, zotëruar i 1 (Nje) kuote me vlerë të përgjithshme 200000(Dyqind mijë) Lekë, që përben 20% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
  - e)
- 2) Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

**Neni 6:**

**Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit**

- 1) Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti te autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.
- 2) Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.
- 3) Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kerkohen për ndryshimin e statutit.
- 4) Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

**Neni 7**

**Transferimi i kapitalit**

- 1) Kuotat e kapitalit të shoqërisë e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
  - a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
  - b) shitblerjes;
  - c) trashëgimisë;
  - d) dhurimit;
 vetem ne rast se kane dakortesine e ortakeve te tjere. Qe veprimet e mesiperme te jene ligjore duhet qe te jene te pranuar dhe firmosur nga te ter ortaket.
- 2) Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, vetem ne rast se kane dakortesine e ortakeve te tjere.
- 3) Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

**KREU III**

**ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE**

**Neni 8**

**Organi Vendimmarrës**

- 1) Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.
- 2) Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë qe miraton çdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te përcaktuara ne ligj
- 3) Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqerinë për çështjet e mëposhtme:
  - a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) ndryshimet e statutit;
  - c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
  - d) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - e) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendor në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;

*[Handwritten signatures]*

Faqe 2 e 7

Statut i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar  
Buddha House shpk

- f) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
  - g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - h) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
  - i) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
  - j) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - k) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
  - l) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
  - m) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- 4) Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.
  - 5) Administratori i shoqërisë mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme, e cila përfshin edhe
  - 6) Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, me të njëtin rend dite.

**Neni 9**

**Mënyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblesë se Përgjithshme**

- 1) Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përparrë datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
- 2) Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

**Neni 10**

**Kuorumi**

- 1) Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkijnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.
- 2) Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkijnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.
- 3) Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëtin rend dite.

**Neni 11**

**Marrja e vendimeve**

- 1) Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave te zotëruesve te kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- 2) Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje te tjera si :
  - a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
  - c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - d) përcaktimin e shpërblimeve
  - e) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
  - f) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - g) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- 3) Çdo ndryshim statuti duhet te depozitohet pranë QKR për te pasqyruar ndryshimet ne skedën e shoqërisë.

**Neni 12**

**Përjashtimi nga e drejta e votës**

**Faqe 3 e 7**

*[Handwritten signatures]*

*Buddha House shpk*

- 1) Ortaku nuk mund tē ushtrojë tē drejtēn e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:
  - a) vlerësimin e veprimitarisë së tij;
  - b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim tē tij;
  - c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
  - d) dhënien ose jo tē përfitimeve tē reja.
- 2) Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet tē jetë në tē njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, tē cilin përfaqëson.


**Neni 13**  
**Administrimi**

- 1) Administratori i shoqërisë emerohet Lorjana Doga atësia Myrto, shtetase shqiptare identifikuar me anë te ID, me numër personal identifikimi J45327087D datëlindjes 27.03.1994, lindur në Kucove dhe banues në Vlore, me afat emërimi 5 vjeçar, duke filluar nga data e emërimit.
- 2) Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë tē shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me tē drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare tē Biznesit.
- 3) Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 tē këtij ligji, nuk mund tē emërohen si administratorë tē një shoqërie tē kontrolluar e anasjelltas.
- 4) Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

**Neni 14**  
**Kompetencat e Administratorëve**

- 1) Administratori ka te drejtë e detyre te:
  - a) kryejnë tē gjitha veprimet e administrimit tē veprimitarisë tregtare tē shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, tē vendosura nga asambleja e përgjithshme;
  - b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
  - c) kujdesen për mbajtjen e saktë e tē rregullt tē dokumenteve dhe tē librave kontabël tē shoqërisë;
  - d) përgatisin dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimitarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
  - e) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcenojnë mbarëvajtjen e veprimitarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
  - f) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë tē dhënat e detyrueshme tē shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare tē Biznesit;
  - g) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi tē veçantë për veprimitarinë e shoqërisë tregtare;
  - h) kryejnë detyra tē tjera tē përcaktuara në ligj dhe në statut.
- 2) Administratoret janë te detyruar te thërrasin Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur:
  - a) sipas bilancit vjetor apo raporteve tē ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
  - b) shoqëria propozon tē shesë apo tē disponoje në mënyrë tjetër aktive, tē cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind tē aseteve tē shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare tē certifikuara.
  - c) shoqëria, brenda 2 viteve tē para pas regjistrimit tē saj, propozon tē blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind tē aseteve tē shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare tē certifikuara.
- 3) Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.
- 4) Asambleja e përgjithshme mund tē shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë tē zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë tē marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

**Neni 15**  
**Përgjegjësitë e Administratorit**

-  1) Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj tē tretëve, për shkelje tē ligjeve, për shkelje tē statutit, apo për faje tē kryera gjatë administrimit tē shoqërisë.
- 

- 2) Pasojat e marrëveshjeve të pa miratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.
- 3) Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:
  - a) të kryejë detyrat e tij te përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjesid;
  - b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
  - c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
  - d) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
  - e) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
- 4) Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
- 5) Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkua. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.
- 6) Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë, dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:
  - a) u kthen ortakëve kontributet;
  - b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
  - c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
  - d) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohet që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
  - e) jep kredi.

**KREU IV  
VITI FINANCIAR, EKSPERTET**

**Neni 16  
Viti Financiar**

- 1) Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përjashtmisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbylltet me 31 Dhjetor.

**Neni 17  
Ekspertet**

- 1) Eksperti ka për detyre qe të kontrolloje të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.
- 2) Ne përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar qe t'jua paraqesë e dorëzojë ne kohë ortakeve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore qe ka.

**KREU V  
PRISHJA, RIORGANIZIMI I SHOQËRISË**

Faqe 5 e 7

Statut i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar  
Buddha House shpk

**Neni 18**  
**Prishja dhe likuidimi**

- 1) Shpërndarje ose prishja e shoqërisë mund të behet ne çdo kohe:
  - a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
  - b) me vendim të Asamblesë se Ortakeve;
  - c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
  - d) nëse nuk ka kryer veprimitari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimitarisë në përputhje me ligjin.
  - e) me vendim të gjykatës;
- 2) Ne ketë rast Ortakët marrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar ne çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtese " Shoqëri ne likuidim e sipër ".
- 3) Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguesve, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.
- 4) Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.
- 5) Nëse Ortakët nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

**Neni 19**  
**Riorganizimi i shoqërisë, bashkimi, ndarja**

- 1) Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."


**Neni 20**  
**Baza Ligjore**

- 1) Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne përputhje te plete me ketë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.
- 2) Për sa nuk parashikohet ne këtë statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjeter specifik ne Republikën e Shqipërisë.

**Neni 21**  
**Mosmarrëveshjet**

- 1) Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin do të zgjidhen me mirëkuptim, në të kundërt do të zgjidhen nëpërmjet organeve të posaçme të njohura nga ligji.


O R T A K Ě T  
E SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
"Buddha House" shpk

Hüseyin Kurutəs  


(Emër, Mbiemër, Nënskrimi)

Hmet Aydogan  


(Emër, Mbiemër, Nënskrimi)

Tunahan Ozurci  


(Emër, Mbiemër, Nënskrimi)

Baran Ozca  


(Emër, Mbiemër, Nënskrimi)